

SPAK

STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

KOMISIONI ANTIKORRUPSION: RE E ZEZË MBI DREJTËSINË E RE

RAPORT MONITORIMI

Qershor 2024



AUTOR
DHIMITËR ZGURO

QENDRESA QYTETARE



www.qeverisja.qq.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
2. PAVARËSIA E INSTITUCIONEVE DHE INSTITUCIONET E PAVARURA	5
2.1. Ndarja dhe balancimi i pushteteve	5
2.2. Institucionet e pavarura dhe mbikëqyrja e tyre	7
3. KONTROLI MBI INSTITUCIONET E PAVARURA	9
3.1. Rezoluta e Kuvendit	9
3.2. Komisioni i Posaçëm Parlamentar.....	13
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	16
BIBLIOGRAFIA	18

1. HYRJJE

Më datë 18 janar 2024, portali “CNA.al” botoi një lajm, sipas të cilit, Partia Socialiste kishte krijuar një komision informal, të përbërë nga Eduard Shalsi, Klotilda Bushka, Etilda Gjonaj, Blendi Çuçi dhe Lindita Nikolla, i cili do t'i paraprinte një komisioni që do të shërbente si mekanizëm kontrolli kundrejt institucioneve të pavarura, veçanërisht, kundrejt Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion (në vijim referuar si “SPAK”).¹ Më herët, “CNA.al” kishte raportuar se në mbledhjen qeveritare, më datë 8 janar 2024, në Shëngjin, Lindita Nikolla kishte vendosur theksin mbi nevojën për kontroll parlamentar mbi institucionet e pavarura.² Po ashtu, në datë 15 janar 2024, Bledi Çuçi, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste nëpërmjet një deklarate në rrjetet sociale³, u shpreh se i kishte kërkuar deputetëve socialistë një dinamikë të re sidomos për çështje që lidhen me integrimin, si dhe të krijojmë një mekanizëm që institucionet e pavarura të kenë një fokus të veçantë lidhur me rekomandimet që jep BE.

Më datë 19 janar 2024, në një konferencë për shtyp, Lulzim Basha denoncoi një nismë të Partisë Socialiste, që sipas tij, synonte të vendoste nën kontroll Strukturën e Posaçme Anti-Korrupsion.⁴ Menjëherë, një ditë më pas, do të vinte dhe reagimi i parë nga Partia Socialiste, ku Eduard Shalsi, i cili ndër të tjera, nuk përjashtoi mundësinë e ngritjes së një komisioni për kontrollin e institucioneve të pavarura, duke përfshirë këtu edhe Strukturën e Posaçme Anti-Korrupsion.⁵ Në lidhje me këtë komision, Shalsi deklaroi se, ngritja e tij duhet të bëhej me qëllim rritjen e kapaciteteve për të monitoruar dhe kontrolluar punën e qeverisë dhe të institucioneve të pavarur.⁶

¹ Për më shumë shih: <https://www.cna.al/newsmobile/387612/>, aksesuar online më 18.06.2024.

² Për më shumë shih: <https://www.cna.al/newsmobile/387573/>, aksesuar online më 18.06.2024.

³ Për më shumë shih: https://www.instagram.com/bledarcuci/p/C2HpFvXN0io/?img_index=1, aksesuar online më 18.6.2024.

⁴ Për më shumë shih: <https://shajptarja.com/lajm/basha-denoncon-planin-e-psse-po-pergatit-komisioni-per-te-kontrolluar-e-goditur-spak>, aksesuar online më 18.6.2024.

⁵ Për më shumë shih: <https://www.youtube.com/watch?v=JtEFlbpoXE>, aksesuar online më 18.06.2024.

⁶ Për më shumë shih: <https://www.cna.al/newsmobile/388479/>, aksesuar online më 18.06.2024.

Përgjatë një mbledhjeje me Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste dhe kabinetin qeveritar, të titulluar "Shqipëria 2030", të mbajtur më 7 maj 2024, Elisa Spiropali prezantoi një draftrezolutë për luftën kundër korrupsionit. Sipas Rezolutës, parashikohej ngritja e një Komisioni të Posaçëm Parlamentar, që do të adresojë ndërmarrjen e reformave që synojnë mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian.⁷ Për këtë rezolutë, si dhe për Komisionin e Posaçëm Parlamentar, Altin Dumani, kreu i SPAK, reagoi përgjatë raportimit vjetor në Kuvendin e Shqipërisë, duke deklaruar se mbrojtja e pavarësisë institucionale dhe siguria juridike duhet të jenë parime që duhet të udhëheqin çdo reformë, si dhe duke kërkuar respektimin e frymës kushtetuese dhe të ndarjes së pushteteve.⁸

Megjithë kundërshtimin e opinionit publik, si dhe të vetë SPAK, si institucioni i pavarur më i synuar për t'u vendosur nën kontroll për shkak të hetimeve dhe ushtrimit të funksioneve të parashikuara në ligj dhe Kushtetutë, Kuvendi i Shqipërisë, më datë 27 maj 2024, miratoi Rezolutën me nr. 1768-1⁹, e cila i hapte rrugën krijimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Ky i fundit, u ngrit me vendimin nr. 50/2024, të datës 30.05.2024, të Kuvendit të Shqipërisë¹⁰.

Ndaj në vijim të këtij Raporti do të ndalemi në arsyet e themelimit të këtij Komisioni, kompetencat e tij, nevojën e mbikëqyrjes parlamentare të institucioneve të pavarura, si dhe tek kërcënimi që i kanoset institucioneve të pavarura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar.

⁷ Për më shumë shih: <https://euronews.al/shqiperia-2030-ne-be-draft-rezoluta-e-prezantuar-ne-mbledhjen-e-grupit-te-ps/>, aksesuar online më 18.06.2024.

⁸ Për më shumë shih: <https://www.reporter.al/2024/05/22/dumani-kerkon-nje-mandat-te-dyte-per-prokuroret-e-spak/>, aksesuar online më 18.06.2024.

⁹ Fletore Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2024, f. 10215.

¹⁰ Fletore Zyrtare nr. 95, datë 06.06.2024, f. 10523.

2. PAVARËSIA E INSTITUCIONEVE DHE INSTITUCIONET E PAVARURA

2.1. Ndarja dhe balancimi i pushteteve

Një nga parimet më të rëndësishme mbi të cilat ndërtohen bazat e një shteti demokratik është ai i shtetit të së drejtës, i cili është reflektuar në nenin 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas të cilit të gjitha institucionet shtetësore duhet të veprojnë sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacisë së Kushtetutës së Republikës kundrejt të gjitha akteve të tjera normative.¹¹ Sipas Gjykatës Kushtetuese që ka bërë interpretimin e këtij parimi, çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkalluar kufijtë e përcaktuar prej tyre.¹² Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se: *“çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.”*¹³

Një nga elementët e shtetit të së drejtës është dhe parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Ky parim synon mënjanimin e rrezikut të përqëndrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që mbart në vetvete rrezikun e shpërdorimit dhe abuzimit të pushtetit.¹⁴ Për këtë arsye, megjithëse aparati shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjes dhe raportesh të ndërsjellta, të krijuara me Kushtetutë.

Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij.

¹¹ Vendimi nr. 15, datë 15.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

¹² Vendimi nr. 14, datë 21.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

¹³ Vendimi nr. 22, datë 24.04.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁴ Vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

Në thelb, në bazë të interpretimit që i ka bërë Gjykata Kushtetuese këtij parimi, të tria pushtetet duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur, por edhe në mënyrë të balancuar, duke mos cënuar dhe mos ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit.¹⁵ Në vijim të interpretimit kushtetues, Gjykata është shprehur se: *“Nëpërmjet këtij parimi kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij”*.¹⁶

Pavarësisht kësaj, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën kushtetuese, vlen të theksojmë se parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet të kuptohet në atë mënyrë që mbyll dhe mban të pakontrolluar secilin prej pushteteve nga çdokush. Ndaj Kushtetuta, krahas ndarjes, flet edhe për balancimin e pushteteve, pasi është e vetmja mënyrë për të parandaluar çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar.¹⁷ Po ashtu, duhet të mbahet në konsideratë se parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk shtrihet vetëm ndaj tri degëve të pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se: *“(…) asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese”*.¹⁸

¹⁵ Vendimi nr. 24, datë 10.11.2016 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁶ Vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁷ Vendimi nr. 43, datë 26.06.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Ibid.

2.2. Institucionet e pavarura dhe mbikëqyrja e tyre

Institucionet e pavarura, të cilat kanë për qëllim të mundësojnë realizimin e një menaxhimi rregullator, funksional, institucional në sistem, janë elementë kryesor i një demokracie funksionale.¹⁹ Studiuesit e së drejtës kanë mbajtur qëndrimin se: *"Institucionet e pavarura nuk krijohen si pjesë e ndonjë prej tre degëve të pushtetit, edhe pse qëllimi i krijimit dhe përfshirjes së tyre në tërësinë e institucioneve publike themelore të shtetit, në thelb është i lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve".*²⁰

Parakusht për veprimin e lirë dhe efektiv të institucioneve të pavarura janë tre kritere: (i) kriteri i pavarësisë financiare, sipas të cilit, institucioneve u jepen fonde të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre me autonomi të plotë; (ii) kriteri i emërimit dhe patundshmërisë në detyrë, sipas të cilit, emërimi kryhet mbi baza të meritokracisë dhe në mënyrë transparente, si dhe anëtarët e organit apo institucionit kanë garancitë e nevojshme kundrejt largimeve apo shkarkimeve të padrejta; si dhe (iii) kriteri i tretë që lidhet me vendimmarrjen, sipas të cilit, vendimmarrja e institucioneve të pavarura nuk mund të jetë subjekt i ndërhyrjes nga palë të treta.²¹

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë institucionet e pavarura janë përfshirë në tërësinë e institucioneve kushtetuese për të funksionuar si mekanizma balancimi, kontrolli apo mbrojtje të themeleve kushtetuese, përfshirë dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.²² Në kuadër të ndarjes që doktrina i ka bërë institucioneve të pavarura, këto të fundit janë klasifikuar në bazë të natyrës apo qëllimit të krijimit.²³ Kështu, në kuadrin e ndarjes së

¹⁹ Eralda (Methasani) Çani, *Institucionet e Pavarura në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese*, Tiranë, 2023. Për më shumë shih: <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Libri-per-Web.pdf>, aksesuar online më 20.06.2024.

²⁰ Ibid.

²¹ OSCE, *Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë*, 2012, f. 6. Për më shumë shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/6/2/92052.pdf>, aksesuar online më 19.06.2024.

²² Eralda (Methasani) Çani, *Institucionet e Pavarura në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese*, Tiranë, 2023. Për më shumë shih: <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Libri-per-Web.pdf>, aksesuar online më 20.06.2024.

²³ Ibid.

pushteteve janë krijuar institucionet si Kuvendi, gjykatat, dhe Këshilli i Ministrave. Në kuadrin e vendosjes së balancës midis degëve të pushteteve, është krijuar Presidenti, Gjykata Kushtetuese dhe prokuroria, ndërsa në kuadrin e garantimit të të drejtave dhe lirive themelore është krijuar Avokati i Popullit dhe Gjykata Kushtetuese. Po ashtu, sipas doktrinës njihen dhe institucione të pavarura që janë krijuar si institucione qeverisëse të ndonjë degë pushteti siç është Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, etj., si dhe institucionet e pavarura që krijohen me qëllim ndjekjen e fushave të specializuara siç janë Banka e Shqipërisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Sikundër është trajtuar dhe nga doktrina e së drejtës, statusi i të qenit i pavaur lidhet me aspekte të ndryshme, ku ndër të tjera, përfshihen dhe këto aspekte: (i) krijimi me Kushtetutë apo me ligj; (ii) pavarësia nga pushteti ekzekutiv qendror; (iii) emërimi i drejtuesit bëhet nga Kuvendi, ose sipas rastit nga organi përgjegjës; (iv) pasja e një mandati të ushtrimit të detyrës; (v) mosdhënia llogari qeverisëse, por vetëm raportimi në Kuvend; (vi) pavarësia strukturore dhe organizative.

Raportimi pranë Kuvendit, si mekanizëm i kontrollit të institucioneve të pavarura, është një nga elementët më thelbësorë për këto institucione, të cilat përgjigjen para Kuvendit për veprimtarinë dhe punën e tyre. Në referim të nenit 103, të Rregullores së Kuvendit, si dhe të ligjeve organike që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të pavarura, këto të fundit, duhet të dorëzojnë një raport vjetor pranë Kuvendit të Shqipërisë, i cili futet në programin e punës së Kuvendit dhe më pas, shqyrtohet në komisionet përgjegjëse karlamentare.²⁴ Në referim të pikës 3, të nenit 103, të Rregullores së Kuvendit, në përfundim të diskutimeve, komisioni përgjegjës harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare, e cila, në zbatim të pikës 7, të nenit 103, të

²⁴ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2024.

Rregullores, leohet pasi titullari i institucionit ka paraqitur një përmbledhje të raportit për seancën plenare.²⁵

Përpos këtij raportimi vjetor periodik që në çdo rast duhet të përfundohet jo më vonë se muaji qershor i vitit pasardhës, mbi institucionet e pavarura rëndon dhe detyrimi për të raportuar dhe informuar në çdo kohë Komisionin për Çështjet Europiane dhe komisionet përgjegjëse, nëse këto të fundit e kërkojnë një gjë të tillë, mbi zbatimin e detyrimeve të procesit të integritit evropian dhe zbatimit të kuadrit ligjor përkatës.²⁶

3. KONTROLI MBI INSTITUCIONET E PAVARURA

3.1. Rezoluta e Kuvendit

Sikundër jemi shprehur dhe më herët, më datë 27.05.2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Rezolutën nr. 1768-1 “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.²⁷

Sipas preambulës, Rezoluta miratohej duke patur në konsideratë rekomandimet e raportit të BE-së për Shqipërinë 2023, raportit screening të Komisionit Evropian, si dhe në deklaratat/rezolutat e Samitit për Demokraci të SHBA-së. Po ashtu, preambula e Rezolutës e vlerëonte reformën në drejtësi si një nga lëvizjet më të mëdha shtetndërtuese në historinë e shtetit shqiptar, ndërsa zbatimin e saj, si domosdoshmëri për jetësimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet tri pushteteve, duke garantuar një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.²⁸ Në vijim,

²⁵ Ibid.

²⁶ Ligj nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, Fletore Zyrtare nr. 38, datë 18.03.2015, f. 1754. Për më shumë shih: <https://qbz.gov.al/preview/387e2f6b-f459-47e6-9e39-b0d249a81f4e/cons/20230424>, aksesuar online më 20.06.2024.

²⁷ Fletore Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2024, f. 10215.

²⁸ Ibid.

mazhoranca qeverisëse pranonte në preambul rezultatet e derisotme pozitive të reformës në drejtësi, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet procesit të vetingut, si dhe nëpërmjet veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion.

Nëpërmjet Rezolutës së miratuar, Kuvendi merrte përsipër tetë angazhime. Megjithatë për efekt të këtij Raporti, do të ndalemi vetëm në angazhimet e marra përsipër që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me synimin e Kuvendit për të ushtruar kontroll mbi institucionet e pavarura, duke përfshirë këtu dhe SPAK-un.

Së pari, Kuvendi angazhohej në nxitjen e frymës së dialogut konstruktiv dhe institucional brenda kuadrit kushtetues e ligjor ndërmjet tri pushteteve, të cilat duhet të forcojnë kulturën e bashkëpërgjegjësisë së institucioneve në avancimin e mëtejshëm të reformave modernizuese.²⁹ Forcimi i kulturës së bashkëpërgjegjësisë së institucioneve duket të jetë një aspekt mjaft i vështirë në zbatim, për aq kohë sa vetë institucioni i Kuvendit ka inicuar një praktikë të rrezikshme për shtetin e së drejtës dhe kushtetueshmërinë duke mos zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, fakt ky që detyroi dhe kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, të deklaronte si më poshtë:

“Është një situatë e pazakontë dhe e pamundur të ndodhë në një vend demokratik. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohen dhe zbatimi i vendimeve të kësaj gjykate përbën zbatim të vetë Kushtetutës. Fjalët janë të tepërta përtej kësaj që unë thashë. Çdo vendim duhet të zbatohet. Nuk ka një rrugë tjetër. Nuk ka një mekanizëm tjetër. Arsyeja pse nuk ka një mekanizëm tjetër është sepse është e pamundur të imagjinohet që të mos zbatohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese. S’mbetet shumë për të interpretuar në këtë moment.”³⁰

²⁹ Fletore Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2024, f. 10215.

³⁰ Për më shumë shih: <https://lajme.rts.al/artikull/mandati-i-olta-xhaces-kryetarja-e-gjik-se-holta-zacaj-kuvendi-te-zbatoje-vendimin-s-ka-rruge-tjeter->, aksesuar online më datë 20.06.2024.

Mos plotësimi i normës ligjore të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 262, të Kodit Penal, si pasojë e shfuqizimit të shprehjes “pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta”, në rastin e organizimit të tubimeve paqësore,³¹ mos plotësimi i boshllëkut ligjor në lidhje me votën e emigrantëve,³² si dhe mungesa e vendimmarrjes për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të Olta Xhaçkës,³³ janë vetëm tre nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat, Kuvendi i ka neglizhuar në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe parimet e shtetit të së drejtës, të sanksionuara në Kushtetutë.

Në këtë kontekst, po aq sa është e paimagjinueshme se si një organ kushtetues si Kuvendi nuk zbaton vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese, është dhe absurde fakti se, pikërisht ky organ, kërkon dhe angazhohet, nga ana tjetër, në forcimin e kulturës së bashkëpërgjegjësisë institucionale.

Së dyti, Kuvendi i Shqipërisë angazhohej që do të ushtronte në mënyrë efektive përgjegjësitë kushtetuese përsa i takon rolit mbikëqyrës ndaj qeverisë, institucioneve të pavaura dhe agjencive ekzekutive ligjzbatuese, brenda kufijve të përcaktuara në Kushtetutë, në përputhje me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.³⁴ Sipas Rezolutës, në këtë drejtim fokusi do të përqëndrohej në adresimin e masave të udhërrëfyesve të miratuar nga qeveria, të cilët nuk janë as më pak dhe as më shumë, sesa dokumente politike dhe strategjike që paraqesin masat kryesore që synohen të ndërmerren në kuadër të procesit të adresimit të gjetjeve të paraqitura nga Komisioni Evropian.

³¹ Vendimi nr. 24, datë 04.05.2021 i Gjykatës Kushtetuese.

³² Vendimi nr. 38, datë 09.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese.

³³ Vendimi nr. 1, datë 23.01.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁴ Fletore Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2024, f. 10215.

Udhërrëfytyesi “Për shtetin e së drejtës – Kapitulli 23 ‘Gjyqësori dhe të drejtat themelore’” parashikon si masa që synohen të ndërmerren, ndër të tjera, përafrimin e mëtejshëm me *acquis communautaire* të legjislacionit që lidhet me luftën kundër korrupsionit, ngritjen e njësive më të specializuara nga SPAK, përfshirë BKH-në, si dhe fuqizimin e prokurorisë dhe gjykatave të SPAK-ut në hetimin proaktiv, ndjekjen penale dhe dënimin për korrupsion përmes burimeve adekuate operacionale dhe njerëzore dhe trajnimeve të synuara.³⁵ Ndërkaq në raportin “Screening” të Komisionit Evropian për Shqipërinë, është sugjeruar se, Shqipëria duhet të bëjë përpunim vendimtar drejt dhënies fund të pandëshkueshmërisë dhe natyrës së përhapur dhe të përgjithshme të korrupsionit, konsolidimin e kapaciteteve operacionale dhe njerëzore të SPAK dhe gjykatave të posaçme drejt trajtimit të pandëshkueshmërisë dhe natyrës së përhapur dhe të përgjithshme të korrupsionit.³⁶

Megjithatë masa të tilla si dhënia fund pandëshkueshmërisë dhe ndërmarrja e hapave konkrete për të frenuar përhapjen e korrupsionit janë masa të tilla që nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit parlamentar, por vetëm kontrollit gjyqësor, pasi gjykatat janë organi i vetëm, i ngarkuar nga Kushtetuta, për dhënien e drejtësisë në emër të Republikës.

Së treti, Kuvendi angazhohej në garantimin e pakthyeshmërisë së reformës në drejtësi, konsolidimin e saj të mëtejshëm dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë, përmes ruajtjes së parimeve dhe shtyllave kushtetuese të reformës në drejtësi, për të fuqizuar pavarësinë dhe paanësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe njëherësh nxitjen e cilësisë së vetëqeverisjes

³⁵ Për më shumë shih: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/661>, aksesuar online më datë 20.06.2024.

³⁶ Për më shumë shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf, aksesuar online më datë 20.06.2024.

së sistemit të drejtësisë nëpërmjet forcimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës.

Po të mbahen në konsideratë gjetjet e Raportit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, konsolidimi i mëtejshëm i reformës në drejtësi dhe rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë, duhet të bëhet ndër të tjera, përmes plotësimit të vakancave të hapura, përmirësimit të funksionimit të gjykatave, thjeshtimit të procedurave gjyqësore, etj. Për nga natyra, disa prej masave të sugjeruara në Raportin e Bashkimit Evropian kanë karakter normativ dhe rregullator, për rrjedhojë, mund të jenë objekt i punës së veprimtarisë së Kuvendit apo organeve të qeverisjes së gjyqësorit, ndërsa masat e tjera kanë një karakter të brendshëm dhe organizativ, të cilat, pikërisht, për shkak të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, nuk mund të jenë objekt i veprimtarisë së Kuvendit. Kështu, gjatë raportimit vjetor në Kuvend mund të ndodhë që kreu i SPAK të njoftojë dhe vendosë në dijeni deputetët mbi disa çështje organizative, por kurrësesi Kuvendi nuk mund të marrë kompetenca dhe të vendosë mbi rregullimin e brendshëm të një institucioni të pavarur.

3.2. Komisioni i Posaçëm Parlamentar

Mbështetur në angazhimet e analizuara më herët, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 30.05.2024, miratoi vendimin nr. 50/2024 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm, për Thelimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.³⁷

Sipas kreut të dytë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar ka për qëllim kryesor të tij të drejtojë dhe të koordinojë një proces të thelluar reformimi, duke patur këto tri synime: (i) së pari, të përmirësojë dhe konsolidojë praktikën e mirëqeverisjes në të gjitha nivelet; (ii) së dyti, të

³⁷ Fletore Zyrtare nr. 95, datë 06.06.2024, f. 10523.

thellojë luftën kundër korrupsionit; dhe (iii) së treti, të forcojë mëtej nivelin e zbatueshmërisë së ligjit.³⁸ Për përmbushjen e këtyre synimeve, veprimtaria e komisionit, fillimisht, do të shtrihej në një afat kohor prej 10 muajsh, dhe do të përbëhej nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 do të ishin përfaqësues të shumicës parlamentare dhe 5 anëtarë të pakicës parlamentare.

Sipas vendimit të Kuvendit, komisioni i posaçëm do të kishte për objekt të veprimtarisë së tij që, nëpërmjet një procesi publik, gjithëpërfshirës e transparent, të realizojë një analizë të situatës aktuale në fushat, që përbëjnë dhe qëllimin e komisionit, si dhe të hartojë dhe miratojë një Plan Kombëtar Veprimi, duke rekomanduar dhe masa konkrete për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale.³⁹ Veprimtaria e komisionit të posaçëm, referuar dhe vendimit nr. 50/2024, të Kuvendit, do të mbështetej në mekanizmat, rregullat dhe procedurat përkatëse parlamentare dhe do të kryhej me angazhimin e kontributin aktiv të ekspertizës më të mirë vendase dhe ndërkombëtare.

Pavarësisht kujdesit të treguar, veçanërisht, në formulimin e objektit të komisionit të posaçëm, duke mbajtur në konsideratë Rezolutën, mbi bazën e të cilit është ngritur ky komision, si dhe deklaratimet e mëhershme të deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, krijimi i një komisioni të posaçëm parlamentar ngre shqetësime reale mbi qëllimin dhe ndikimin real që do të ketë veprimtaria e tij. Pavarësisht konstituimit të tij më datë 11 qershor 2024,⁴⁰ dhe bojkotit të opozitës parlamentare, historia ka treguar se partitë politike në Shqipëri jo në pak raste janë bërë bashkë për të miratuar ndryshime, të cilat megjithëse kanë krijuar pasoja mbi qytetarët, kanë gjeneruar përfitime për palët.

³⁸ Ibid.

³⁹ Fletore Zyrtare nr. 95, datë 06.06.2024, f. 10523.

⁴⁰ Për më shumë shih: <https://euronews.al/konstituohet-komisioni-anti-korrupsion-maxhoranca-i-shtrindoren-opozites/>, aksesuar online më datë 02.07.2024.

Nga ana tjetër, pretendimet për më shumë transparencë nga ana e mazhorancës qeverisëse duhet të konsiderohen me rezerva pasi mund të ndodhemi përballë një përpjekjeje të fshehur për të ushtruar kontroll mbi institucionet e pavarura, të cilat janë kritike për ruajtjen e kontrollit dhe balancës brenda shtetit.

Gjuha e paqartë dhe jo koncize, veçanërisht, në përcaktimin e objektit të komisionit parlamentar, por edhe në Rezolutën, mbi të cilën ky komision është ngritur, në drejtim të hartimit të një Plani Kombëtar Veprimi dhe për të rekomanduar ndryshime ligjore dhe institucionale, lë hapësira për interpretime të zgjeurara që mund të minojnë eventualisht pavarësinë dhe efektivitetin e institucioneve të pavarura. Po ashtu, paqartësitë në terminologjinë e përdorur në përkufizimin e veprimtarisë së komisionit dhe Rezolutën përkatëse mund të shërbejnë për fokusimin e veprimtarisë në një çështje të caktuar, në mënyrë selektive, me qëllim që komisioni t'i shërbejë një agjende specifike, në vend që të adresojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe asnjëanëse sfidat.

Referimi tek mekanizmat dhe procedura parlamentare, si dhe përfshirja e ekspertizës vendase dhe ndërkombëtare, nuk mund të shërbejë në asnjë rast si një garanci se, gjetjet dhe rekomandimet e komisionit të posaçëm nuk do të politizohen apo manipulohen në atë formë, që i shërben më mirë interesit partiak dhe jo interesit publik. Po ashtu, përbërja e komisionit, sikundër dhe në rastet e tjera, nuk garanton mos përdorimin e rekomandimeve për qëllime ngushtësisht partiake apo elektorale, kjo për vetë faktin se përfaqësuesit e mazhorancës kanë shumicën në komision dhe pavarësisht çdo gjetjeje që komisioni mund të bëjë, raporti i komisionit dhe vendimmarrja do të jetë në dorën e mazhorancës.

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim, vlen të theksojmë se, krijimi i një komisioni të posaçëm parlamentar, të ngritur nën premisat se ky i fundit do të kontribuojë në mirëqeverisje, forcojë sundimin e ligjit dhe luftojë korrupsionin, ngre shqetësime të rëndësishme dhe të bazuara në lidhje me qëllimin e vërtetë të ngritjes së këtij komisioni, si dhe mundësinë për përdorimin e këtij komisioni, që ka për atribut dhe rekomandimin e masave legislative, si një bazë për fillimin e një procedure reformimi të kuadrit ligjor mbi institucionet e pavarura, dhe veçanërisht mbi Strukturën e Posaçme Anti-Korrupsion me qëllim, zvogëlimin e kompetencave të kësaj të fundit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe parandalimit të tyre.

Mënyra e ngritjes së komisionit, si dhe shpejtësia me të cilin u ngrit nga momenti i miratimit të Rezolutës, mbi të cilën do të veprojë, dëshmojnë seriozitetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në përpjekjen institucionale për të adresuar çështjet që lidhen me sundimin e ligjit, mirëqeverisjen dhe korrupsionin. Serioziteti i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është një çështje mjaft delikate dhe që duhet të konsiderohet, veçanërisht, po të mbahet parasysh se së fundmi, Kuvendi nga një mekanizëm kontrolli për pushtetin ekzekutiv është kthyer në një mekanizëm mbrojtës të këtij të fundit duke penguar zbatimin e vendimeve përfundimtare të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, vetë ngritja e komisionit të posaçëm parlamentar përbën një kërcënim dhe precedent të rrezikshëm për pavarësinë e institucioneve, shtetin e së drejtës, demokracinë dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kjo pasi aktualisht, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, gëzon të drejtën për të ushtruar kontrollin parlamentar mbi institucionet e pavarura përmes raportimit të këtyre të fundit, dhe nuk është e qartë se si, Kuvendi planifikon të zgjerojë mënyrën e kontrollit mbi institucionet e pavarura, kur çdo formë tjetër kontrolli, do

të përbënte një cënim të pavarësisë së institucionit dhe të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Në një kontekst të tillë, duke mbajtur në konsideratë rreziqet eventuale, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga mazhoranca qeverisëse duhet të heqë dorë nga ngritja e këtij komisioni, tashmë të konstituar, duke vendosur shpërndarjen e këtij komisioni. Krahas shpërndarjes së komisionit të posaçëm parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë duhet që t'i fokusojë përpjekjet e veta institucionale drejt forcimit të mekanizmave ekzistuese të kontrollit parlamentar, por edhe të vetë institucioneve të pavarura, duke ofruar më shumë garanci në drejtim të pavarësisë së tyre institucionale, financiare dhe strukturore.

Po ashtu, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të përqëndrojë përpjekjet e veta institucionale në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve, qofshin ato operationale, qofshin ato njerëzore, të institucioneve të pavarura, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet mbështetjes financiare, si dhe përmirësimit të legjislacionit, në ato raste kur vetë institucionet e pavarura, e gjykojnë të nevojshme.

5. BIBLIOGRAFIA

- Eralda (Methasani) Çani, Institucionet e Pavarura në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Tiranë, 2023. <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Libri-per-Web.pdf>
- Fletore Zyrtare nr. 91, datë 30.05.2024
- Fletore Zyrtare nr. 95, datë 06.06.2024
- <https://euronews.al/konstituohet-komisioni-anti-korrupsion-maxhoranca-i-shtrin-doren-opozites/>
- <https://euronews.al/shqiperia-2030-ne-be-draft-rezoluta-e-prezantuar-ne-mbledhjen-e-grupit-te-ps/>
- <https://lajme.rtsh.al/artikull/mandati-i-olta-xhakes-kryetarja-e-gjik-se-holta-zacaj-kuvendi-te-zbatoje-vendimin-s-ka-rruge-tjeter->
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf
- <https://shqiptarja.com/lajm/basha-denoncon-planin-e-psse-po-pergatit-komisioni-per-te-kontrolluar-e-goditur-spak>
- <https://www.cna.al/newsmobile/387573/>
- <https://www.cna.al/newsmobile/387612/>
- <https://www.cna.al/newsmobile/388479/>
- https://www.instagram.com/bledarcuci/p/C2HpFxXN0io/?img_index=1
- <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/661>
- <https://www.reporter.al/2024/05/22/dumani-kerkon-nje-mandat-te-dyte-per-prokuroret-e-spak/>
- <https://www.youtube.com/watch?v=JtEflbpoXE>
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2024.
- Ligj nr. 15/2015, "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian", Fletore Zyrtare nr. 38, datë 18.03.2015. <https://qbz.gov.al/preview/387e2f6b-f459-47e6-9e39-b0d249a81f4e/cons/20230424>
- OSCE, Gjendja e institucioneve të pavarura në Kosovë, 2012, f. 6. <https://www.osce.org/files/f/documents/6/2/92052.pdf>
- Vendimi nr. 1, datë 23.01.2023 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 14, datë 21.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 15, datë 15.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 i Gjykatës Kushtetutese
- Vendimi nr. 22, datë 24.04.2015 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 24, datë 04.05.2021 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 24, datë 10.11.2016 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 38, datë 09.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi nr. 43, datë 26.06.2015 i Gjykatës Kushtetuese

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AND DEMOCRACY
WORLDWIDE

www.qeverisja.qg.com.dj